

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Betsson Malta Holding Limited, me seli të regjistruar në 199 Experience Centre, Ta’Xbiex Seafront, Ta’Xbiex, XBX 1027, Maltë, përmes Shoqërisë së Avokatëve Çoku dhe Partnerëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 10.06.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Betsson Malta Holding Limited, me seli të regjistruar në 199 Experience Centre, Ta’Xbiex Seafront, Ta’Xbiex, XBX 1027, Maltë, do të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Rhino Vault Holdings Limited, me seli të regjistruar në Spinola Park, Nivel 4 Jug, Triq Mikiel Ang Borg, San Giljan, SPK 1000, Maltë, përmes blerjes së pjesëve të kapitalit, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 denarë, si dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra dhe programi i të hyrave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin vijues: Ligji), më datë 18.05.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin vijues: Komisioni) është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Betsson Malta Holding Limited, me seli të regjistruar në 199 Experience Centre, Ta’Xbiex Seafront, Ta’Xbiex, XBX 1027, Maltë, me të cilin Betsson Malta Holding Limited do të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Rhino Vault Holdings Limited, me seli të regjistruar në Spinola Park, Nivel 4 Jug, Triq Mikiel Ang Borg, San Giljan, SPK 1000, Maltë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimin të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Betsson Malta Holding Limited është shoqëri e themeluar në Maltë, veprimtaria kryesore afariste e së cilës përbëhet nga ofrimi i shërbimeve për lojëra online dhe baste, duke përfshirë kazino, poker, baste sportive, bingo dhe lojëra të menjëhershme. Betsson është pjesë e Betsson Group, e cila operon përmes disa markave në tregje të rregulluara dhe përfaqëson një emër të njohur në fushën e lojërave online. Produktet e Betsson Group përfshijnë Kazino (Casino), Sportsbook (Sportsbook), si dhe lojëra të tjera, të cilat ofrohen përmes veprimtarisë së licencuar.

Betsson nuk ka shoqëri të regjistruara të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk kryen asnjë aktivitet afarist në tregun maqedonas. Rhino Vault Holdings Limited është shoqëri nga Malta, pjesë e grupit të shoqërive Rhino Entertainment („Grupacioni Rhino Entertainment“). Rhino Vault, drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes shoqërive të varura, së bashku me subjektet e tjera brenda Grupit Rhino Entertainment, kryen aktivitete afariste për lojëra online për business-to-consumer („B2C“) në Kanada (duke përfshirë Ontarion dhe pjesën tjetër të Kanadasë), të cilat kryhen në bazë të licencave përkatëse për lojëra, komponentëve teknologjikë të një veprimtarie të tillë afariste dhe pronësisë intelektuale të ndërlidhur me të. Përveç veprimtarisë B2C, Rhino Vault posedon gjithashtu teknologji të vetën front-end dhe middleware për operacione B2B.

Rhino Vault ka një shoqëri të varur në pronësi të plotë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shoqërinë e sapo themeluar maqedonase – NEHA PLAY LIMITED SHPKNJP Manastir, me seli të regjistruar në rrugën Mitropolska nr. 13, Manastir, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe veprimtari prioritare 82.100 – Veprimtari administrative dhe ndihmëse zyre. Më konkretisht, veprimtaria afariste e shoqërisë së sapo themeluar maqedonase përbëhet nga ofrimi i shërbimeve teknologjike, përkatësisht mirëmbajtja dhe servisimi i softuerit në pronësi të saj, i cili “lidh” sisteme të ndryshme (middleware) dhe teknologjinë front-end për nevojat e Grupit Betsson.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ